



BASHKIA  
TIRANË  
REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 49, datë 14.05.2020

**“PËR  
NJË KORRIGJIM GABIMI MATERIAL NË VENDIMIN NR. 28, DATË 24.03.2020, TË  
KËSHILLIT BASHKIAK “PËR KRIJIMIN E LEHTËSIRAVE FISKALE NDAJ BIZNESIT  
DHE SHTYRJEN E AFATEVE TË APLIKIMIT PËR PROGRAMET SOCIALE TË  
STREHIMIT NË KUADËR TË MASAVE PËR PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË  
INFEKSIONIT COVID-19”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 23, pika 6, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 112, të Ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, vendimit nr. 243, datë 24.3.2020, të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, Vendimit nr. 48, datë 11.11.2015, të Këshillit Bashkiak “Për krijimin e Tirana Parking si institucion në varësi të Bashkisë Tiranë për administrimin e shërbimit të parkimit publik me pagesë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

Në vendimin nr. 28, datë 24.03.2020, të Këshillit Bashkiak “Për krijimin e lehtësirave fiskale ndaj biznesit dhe shtyrjen e afateve të aplikimit për programet sociale të strehimit në kuadër të masave për parandalimin e përhapjes së infeksionit Covid-19”, bëhet ndreqja e gabimit material si më poshtë:

1. Në pikën 3, pas togfjalëshit “Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore”, shtohen fjalët “Tirana Parking”.
2. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe Tirana Parking për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

KRYETARI

TONI GOGU

